

1 E mërkurë, 19 shkurt 2025

2 [Konferencë për ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit paraqitet përmes videolidhjes]

5 [I akuzuari Thaçi nuk paraqitet]

6 --- Seanca fillon në orën 9.01

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
14 procesverbal, z. Selimi, z. Veseli dhe z. Krasniqi po na
15 ndjekin përmes videolidhjes. Z. Thaçi ka hequr dorë nga e
16 drejta për të marrë pjesë në seancën e sotme me miratimin e
17 avokatit të tij.

18 E planifikuar këtë seancën e sotme sepse Prokuroria nuk
19 kishte më dëshmitarë për këtë javë. Dhe duam të shfrytëzojmë
20 këtë mundësi që të diskutojmë afatet, kalendarin për mbylljen
21 e çështjes së Prokurorisë dhe hapat për të ardhmen. Kam
22 qarkulluar një rend dite të shkurtër. I marrim sipas radhës që
23 i kemi vendosur në rendin e ditës, ju lutem.

24 Sidoqoftë dua të them fillimisht diçka. Në fakt dua t'i
25 drejtohem Prokurorit. Javën tjetër keni dy dëshmitarë. Do

1 ndodhi, apo jo?

2 Z. PACE: [Përkthim] Po, kemi dy dëshmitarë. Është
3 Dëshmitari 4745, 2677.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
5 dëshmitar rezervë?

6 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dy. Ka pasur
8 disa pyetje, parashtime të protokolluara.

9 Z. Selimi, keni diçka?

10 I AKUZUARI SELIMI: [Përmes videolidhjes] Më falni, se po
11 ndërhyj po desha t'ju njoftoj që nuk kemi, nuk kemi përkthim
12 shqip.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
14 Mirë. Në rregull. Ta zgjidhim këtë.

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
16 këshillohen]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e testojmë
18 njëherë. Testim. Na dëgjoni? Na të dëgjoni, z. Selimi?

19 I AKUZUARI SELIMI: [Përmes videolidhjes] Po, tani në
20 rregull është. Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
22 shumë që na njoftuat, z. Selimi.

23 I AKUZUARI SELIMI: [Përmes videolidhjes] Të lutem.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Tani,
25 unë po flisja, që të jemi të qartë, ka pasur disa pyetje

1 lidhur me dosjet pasgjyqësore që do të dorëzohen. Edhe ne do
2 të kërkojmë që të dorëzohen dosjet njëherazi, dosjet
3 përfundimtare gjyqësore.

4 Së pari, të flasim pak për mbylljen e provave të
5 Prokurorisë.

6 Në konferencën e fundit që patëm më 22 janar, Prokuroria
7 kishte parashikuar që do të përfundonte me dëshmitarët e vet
8 brenda 4 prillit 2025. Dua ta konfirmoj edhe një herë me
9 Prokurorin. I qëndroni kësaj?

10 Z. HALLING: [Përkthim] 4 prill është data e fundit e
11 parashikuar. Nuk do thërrasim asnjë dëshmitar pas kësaj date.
12 Brenda 15 prillit do dorëzojmë mocionet e fundit me shkrim,
13 mocione jогоjore, provat përkatëse. E kemi këtë datë në
14 përputhje me atë që ka thënë Trupi Gjykses në konferencën e 1
15 tetorit 2024. Kjo është data që është planifikuar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë, do
17 përfundoni brenda 15-s me provat tuaja?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Po, po nuk do kemi dëshmitarë të
19 tjerë pas datës 4 prill.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Kjo është e qartë. Do të kem edhe disa aspekte të tjera për të
22 trajtuar, megjithatë desha të sqaroja fillimisht këtë pikë.

23 Do të keni ndonjë problematikë me dëshmitarët e mbetur,
24 mendoni se do të keni ndonjë vështirësi?

25 Z. PACE: [Përkthim] Dua të përgjigjem unë për këtë.

1 Për t'ju dhënë një përditësim me dëshmitarët, javën
2 tjetër kemi dy dëshmitarë. Për marsin kemi një dëshmitar. Dhe
3 do t'ju japim përditësime për dëshmitarë të tjerë që mund të
4 jenë planifikuar për marsin sapo ta kemi këtë përditësim.

5 Sa i takon ndonjë problematike. Sikurse kemi thënë më
6 herët, disa prej dëshmitarëve që kanë mbetur kanë probleme të
7 ndërlikuara që lidhen me sigurinë, me përgatitjen,
8 bashkëpunimin me shtetet e treta, sidoqoftë ne po bëjmë të
9 pamundurën brenda mundësive tona.

10 Rishtazi ju njoftuam që do të kemi shkurtim të
11 mëtutjeshëm të dëshmitarëve, i referohem parashtimit të
12 protokolluar 2877 të 30 janarit të këtij viti dhe kemi
13 njoftuar dhe Ekipet e Mbrojtjes me email lidhur me këtë. Do ju
14 njoftojmë për ndryshime të mëtutjeshme që mund të kenë lidhje
15 me tri a katër dëshmitarë në fund të kësaj jave. Ka mundësi që
16 të kërkojmë pranimin e dëshmimeve të dëshmitarëve me shkrim dhe
17 të mos i sjellim *live* në sallën e gjyqit.

18 Gjithashtu në përputhje me udhëzimet që keni dhënë ju, do
19 t'i bëjmë njoftimet në momentin e duhur, nuk do të presim
20 momentin e fundit.

21 Siç tha dhe z. Halling, nuk do të bëjmë kërkesë të re për
22 dëshmitarë të rinj pas 4 prillit, që ka qenë e planifikuar në
23 kalendar, që do të thotë të gjithë dëshmitarët do të vijnë
24 brenda marsit. Sigurisht, mund të ketë ndonjë situatë të
25 jashtëzakonshme, për këtë do ju bëjmë kërkesë, por ne për

1 momentin nuk kemi paraparë asgjë të këtij lloji.

2 Kjo ishte një panoramë e shkurtër sa i takon dëshmitarëve
3 në sallën e gjyqit. Nëse dëshironi, mund të flasim për
4 dëshmitarët e 153 dhe 155, rregullës pra, 153 dhe 155 dhe me
5 kaq do të mbyll parashtrimet për dëshmitarët.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Që të jem unë
7 i qartë, ju nuk parashikoni që të keni ndryshime në datën e
8 fundit? Data e fundit mbetet ajo që është?

9 Z. PACE: [Përkthim] Po.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë,
11 Data e fundit do të jetë data kur do vijë dëshmitari i fundit?

12 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk do ketë asnjë ndryshim për
13 momentin. Po nëse do ketë ndonjë ndryshim, do ju njoftojmë. Po
14 kemi problematike me shtetet e treta, për shembull, sepse
15 afatet që ju japim ne janë afatet që na mundësojmë ne t'i
16 thërrasim dëshmitarët brenda marsit ose të bëjmë kërkesë me
17 shkrim pastaj që t'i pranohet dëshmia me shkrim dhe të mos i
18 sjellim fizikisht në sallën e gjyqit.

19 Po edhe një herë e përsëris, nëse është nevoja që
20 dëshmitarët të vijnë fizikisht në sallën e gjyqit do të ndodhë
21 brenda 4 prillit.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje. Që
23 Mbrojtja të jetë e përgatitur, keni menduar të hiqni ndonjë
24 nga dëshmitarët që keni në listë, keni ndonjë mendim që nuk do
25 të thërrisni një a më shumë se këta dëshmitarë?

1 Z. PACE: [Përkthim] Nëse do të bëjmë ndryshime të këtij
2 lloji, çka do të thotë heqjen e ndonjë dëshmitari, do ju
3 njoftojmë menjëherë. Por deri tani nuk e kemi menduar këtë,
4 prandaj dhe s'ju kemi ndryshuar, prandaj edhe s'ju kemi marrë
5 vendim përfundimtar lidhur me këtë. Sigurisht që dhe ne duam
6 që dhe Mbrojtja të jetë e informuar, duam të jemi të drejtë me
7 të gjithë. Edhe një herë, kur të marrim një vendim të këtij
8 lloji, do t'ju njoftojmë menjëherë.

9 Ekziston mundësia që ndonjë prej dëshmitarëve që kanë
10 mbetur të mos e thërrasim më. Për ata që do të vijnë në sallën
11 e gjyqit do kërkojmë që të pranohet dëshmia me shkrim. Nëse do
12 të marrim këtë vendim, pra, që të pranohet dëshmia me shkrim,
13 në momentin e duhur do të njoftojmë Mbrojtjen.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam unë një pyetje. Më lejoni?

15 Se unë jam pak i paqartë të paktën. Z. Pace, tha, "Për
16 bllokun e marsit do të thërrasim një dëshmitar", tha, z. Pace
17 dhe më pas tha dhe e përdori në shumës. Do këtë vetëm një
18 dëshmitar për marsin apo më shumë, do na njoftoni, ju lutem,
19 që të përgatitemi?

20 Z. PACE: [Përkthim] Mund të përgjigjem. Për momentin, i
21 vetmi dëshmitar i konfirmuar për bllokun e marsit është
22 Dëshmitari W04403. Dëshmitarët e tjerë që do të thërrasim ende
23 nuk i kemi evidentuar. Por ju thamë që, nëse do të kemi
24 dëshmitarë të tjerë që do t'i konfirmojmë për marsin, do t'ju
25 njoftojmë për bllokun e marsit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E morët
2 përgjigjen?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani dua të
5 flasim për aplikimet, kërkesat e rregullës 153 dhe 155. Në
6 seancën e fundit të kësaj natyre që patëm në janar, më 22
7 janar, ZPS-ja tha se synonte të dorëzonte një kërkesë sipas
8 rregullës 153 përfundimtare më 21 shkurt se ZPS-ja kishte dhe
9 një kërkesë tjetër sipas rregullës 155, por që nuk e dinte se
10 kur do ta dorëzonte këtë kërkesë.

11 Së pari, duam prej ZPS-së nëse synojnë ende të dorëzojnë
12 kërkesë sipas rregullës 153 brenda 21 shkurtit sikurse vetë e
13 kanë thënë në shkuarën? Fillojmë një herë më këtë.

14 Z. PACE: [Përkthim] Po. Synojmë të dorëzojmë një kërkesë
15 sipas rregullës 153 për dëshmitarët që e dimë që do jenë
16 dëshmitarë të rregullës 153 dhe këtë do ta bëjmë brenda kësaj
17 jave. Është informuar Mbrojtja për katër dëshmitarët që do të
18 përfshihen në këtë mocion dhe e kemi marrë dhe përgjigjen prej
19 Mbrojtjes lidhur me këta dëshmitarë, dje e morëm përgjigjen.
20 Unë mund t'ju jap një përmbledhje të parashtrimeve tona, por
21 Mbrojtja aktualisht nuk kundërshton që të pranohen dy prej
22 këtyre deklaratave sipas rregullës 153. Për dëshmitarin e
23 tretë nuk kundërshton Mbrojtja, por kërkon që t'i bëhen disa
24 redakte materialeve dhe ne jemi pajtuar me këtë. Pra, janë
25 katër dëshmitarë të përfshirë në mocionin përkatës. Edhe

1 sigurisht, kemi diskutuar me Mbrojtjen lidhur me këto.

2 Nëse do jetë ky i fundit? Ka të ngjarë që jo. Nuk do të
3 jetë mocioni i fundit, kjo është sepse gjërat janë në zhvillim
4 e sipër. Për shembull, të gjithë dëshmitarët që nuk janë
5 parashikuar për javën tjetër ose ai që është parashikuar në
6 bllokun e marsit, disa do jenë të rregullës 153, disa do jenë
7 të rregullës 155, disa mund të vijnë fizikisht këtu.

8 Sapo të marrim një vendim lidhur me këtë do të dorëzojmë
9 kërkesë tjetër sipas rregullës 153.

10 Për shembull, pse është e nevojshme kujtohet dhe nuk mund
11 të dorëzojmë diçka brenda kësaj jave, siç ju kujtohet, ju e
12 keni rrëzuar pranimin e një dëshmitari me parashtrimin e
13 protokolluar F9237 dhe na njoftuat vetëm të hënën për këtë,
14 tani, ne duhet ta shqyrtojmë vendimin tuaj dhe të vendosim në
15 se do ta thërrasim dëshmitarin fizikisht që të japë dëshmi apo
16 do t'i japim ndonjë alternativë tjetër sesi ta trajtojmë
17 rastin e këtij dëshmitari, për shembull, të pranojmë
18 materialin e këtij dëshmitari sipas rregullës 153.

19 Sidoqoftë, numri i dëshmitarëve që do të përfshihet në
20 kërkesat e rregullës 153, pas kësaj të premtjeje, ka të bëjë,
21 është një numër shumë i kufizuar se në fund të fundit kanë
22 ngelur shumë pak dëshmitarë. Nga këta dëshmitarë alternativat
23 janë të kufizuara: o do vijnë fizikisht në mars, o do jenë
24 sipas rregullës 155, o do jenë sipas rregullës 153, këto janë
25 alternativat. Kjo do jetë në varësi të zhvillimeve që do të

1 ndodhin në të ardhmen.

2 Këto janë parashtrimet për rregullën 153 që kemi ne.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne na duhet
4 sa më shumë informacion, na dhe shumë informacion të
5 përgjithshëm, në vija shumë të përgjithshme, ne dhe Mbrojtja
6 duam të dimë kur do t'i kryeni këto, kur është data e fundit,
7 kur do ta merrni ju vendimin përfundimtar?

8 Z. PACE: [Përkthim] Sikurse ju thashë sa i takon
9 vendimeve, ka disa faktorë që ndikojnë në këto vendime:
10 Bashkëpunimi i dëshmitarëve, dëshmitë që dëgjojmë në sallën e
11 gjyqit edhe varet nga vlerësimet sa i takon provave të
12 Prokurorisë që bëhen. Ju garantojmë që ne nuk duam ta vonojmë
13 aspak procesin gjyqësor dhe do ju njoftojmë në kohën e duhur.

14 Por, unë po ju them që të gjitha kërkesat që janë të
15 nevojshme t'i dorëzojmë, do t'i dorëzojmë ose përpara afatit
16 të prillit ose brenda asaj date ose atë datë.

17 Sa i takon modaliteteve, unë e kam thënë edhe më përpara
18 në parashtrimet e mia. Sa i takon dëshmitarëve që kanë mbetur
19 që këtë javë, do t'ju japim ndryshime të mëtutjeshme që lidhen
20 me tri a katër dëshmitarë që e përmenda më herët, e ceka më
21 herët. Dhe për këta dëshmitarë do ju kërkojmë që të pranohen
22 me shkrim deklaratat.

23 Ju thatë, na thoni më shumë detaje. Nuk kemi 50, 100
24 dëshmitarë. Vetëm 20 dëshmitarë kanë ngelur tashmë. Dhe ju
25 thashë, disa prej dëshmitarëve do vijnë në sallën e gjyqit,

1 disa do pranohen sipas rregullës 153, 155, ndryshimet do ua
2 japim brenda kësaj jave dhe do ngelen shumë, shumë pak
3 dëshmitarë.

4 Kështu që edhe nëse do bëjmë mocione, këto mocione do
5 përfshijnë një numër shumë të kufizuar dëshmitarësh.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të njëjtën
7 pyetje kam tani për 155, rregullën 155, dëshmitarët e
8 rregullës 155. Të dimë kë synoni të përfshini në këtë rregull?

9 Z. PACE: [Përkthim] Po. Sipas rregullës 155 ka arsye pse
10 ne bëjmë kërkesa. Një është e qartë, ne do ta dimë nëse do
11 kërkojmë të pranohen deklarata e një dëshmitari që sipas 155
12 nëse ka vdekur dëshmitari, për këtë e kemi zakonisht
13 informacionet ose ka raste frikësimi, që janë raste pak më të
14 komplikuara. Për disa nga këto nuk mund t'ua them tani cilët
15 dëshmitarë do jenë sipas rregullës 155, sidoqoftë jemi duke
16 përgatitur të gjitha materialet lidhur me dëshmitarët e
17 rregullës 155.

18 Rrjedhimisht, sa utakon kërkesave që do të bëjmë, do të
19 bëjmë një kërkesë për rregullën 155 këtë javë për dy
20 dëshmitarë dhe Mbrojtja e di për cilët dëshmitarë e kemi
21 fjalën. Do bëjmë dhe një kërkesë tjetër sipas rregullës 155.

22 Por ju thashë edhe një herë janë shumë pak dëshmitarë të
23 mbetur në listën tonë. Numri i kufizuarve i dëshmitarëve do të
24 trajtohet i gjithi brenda marsit, qoftë me shkrim, qoftë
25 fizikisht në sallën e gjyqit, do jenë pastaj ose sipas

1 rregullës 155 ose sipas rregullës 153.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të flasim
3 tani për mocionet e paraqitjes së provave jogojore. Në fakt
4 një mocion të tillë ju e keni depozituar sot, mbase dje,
5 kishte 300 pika afërsisht, 300 materiale. E kam kuptuar qartë
6 që mbeten dhe pesë mocione të tjera për prova jogojore në të
7 ardhmen?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e di nëse numri do jetë fiks
9 pesë, por ka edhe mocione të tjera. Mund t'i grupojmë në
10 mënyra të ndryshme, por siç e kemi menduar tani është zona e
11 Dukagjinit, mocioni për zonën e Dukagjinit që e ceka në
12 konferencën e fundit.

13 Është Shtabi i Përgjithshëm e përmendëm mocionin për
14 këtë. Do t'u çojmë, do t'ju dërgojmë një email ekipeve të
15 Mbrojtjes, faktikisht dje i kemi dërguar një email ekipeve të
16 Mbrojtjes për këtë mocion për Shtabin e Përgjithshëm, prandaj
17 dhe do të presim deri në fund të muajit komente.

18 Ka dhe kategori të tjera që kanë mbetur të materialeve -
19 janë raporte ndërkombëtare, disa video. Se sa mocione do jenë
20 nuk e dimë, duam që t'i grupojmë në atë mënyrë që të kenë
21 kuptim. Por ka disa kategori të tjera që mbeten për mocionet
22 të cilat sigurisht do të mbeten për t'u parashtruar brenda
23 datës përkatëse.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju sigurisht
25 që i dini se çfarë materialesh mbeten, më intereson të di nëse

1 e keni numëruar?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Numërimin nuk e dimë, sepse në
3 fakt, i analizojmë gjatë procesit. Duam që të paraqesim për
4 pranim në prova gjyqësore vetëm ato materiale që janë të
5 domosdoshme, është një numër që ndryshon me kalimin e kohës.

6 Mocioni që përmendi, të nderuar Gjykatës, për Pashtrikun
7 janë mbi 300, rreth 300 materiale. Ndërsa për Shtabin e
8 Përgjithshëm, siç është tani, janë rreth 500 materiale. Por ky
9 është mocioni më i madh i parashikuar prej nesh që mbetet për
10 t'u parashtruar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, numri
12 s'na e jepni dot afërsisht?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk jua jap do një numër që të
14 jetë i kuptimtë, por numri do të jetë -- nëse mocioni për
15 Dukagjinin është i ngjashëm me zonën e Pashtrikut dhe mocioni
16 për Shtabin e Përgjithshëm është më i madhi, unë nuk mendoj se
17 mocionet e fundit do të jenë të ngjashme me këto. Kjo është
18 një çmuarje e përgjithshme.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni,
20 Çfarë thatë?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbetemi me frymën pezull, duam të
22 dëgjojmë një numër.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Po unë do thosha që ky numër i
25 përfaqëson do ishte shumë i pasaktë. Plus që dhe mbetet për t'u

1 bërë një analizë nga lista e provave materiale, sepse shumë
2 materiale të listës së provave materiale nuk janë çuar deri në
3 fund sepse janë hequr nga lista e dëshmitarëve disa dëshmitarë
4 dhe kjo pastaj varet sesi do të dorëzohen.

5 Dhe lista e provave materiale ka materiale dhe në shqip
6 dhe në anglisht, pra, nuk do të shërbente si një numër i
7 përfaqësues.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na intereson
9 vetëm një farë ndihme nga ana juaj.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Po shifrat shumë të përfaqësuara për
11 mocionet e ardhshme janë ato që unë thashë. Ndërsa mocionet e
12 fundit do jenë shumë më të vogla se këto, po nuk e di sesa.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky
14 informacion që dhatë ju nuk është informues. Nuk është ajo që
15 kërkojmë me saktësi.

16 Keni ndonjë pyetje për ZPS-në? A kishit ju një pyetje.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
18 Smith. Kam nja dy, po janë më shumë sugjerime.

19 E para është ajo që tha z. Misetic që po dëgjon me frymën
20 pezull. Nuk duam të mbetet pa frymë. Mbase një sugjerim që
21 duhet mbani parasysh z. Halling është ky: Nëse nuk jeni në
22 gjendje që t'i jepni Mbrojtjes një shifër, kur mendoni që ta
23 dërgoni këtë email që ju përmendët për mocionet e tjera për
24 provat jогоjore për t'i informuar për materialet që mbetën?
25 Sigurisht, as unë, as Mbrojtja, mendoj unë, nuk pret që të

1 marrë nga ju një listë të plotë apo të saktë, po do të ketë
2 një ide të përgjithshme dhe natyrën e përgjithshme të këtyre
3 materialeve.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kuptuam. Do ta bëjmë këtë deri
5 në mes të marsit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si thatë?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Në mes të marsit.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dhe një gjë të dytë
9 për të thënë dhe ju pastaj mund të bëni ç'të doni me këtë që
10 do them unë.

11 Ju keni kërkuar që të pranohen në prova gjyqësore faqe të
12 ndryshme librash, këtë e keni bërë në përputhje me rregullën -
13 - me urdhrin - më falni - për të mos paraqitur materiale të
14 panevojshme. Por ndonjëherë, unë do thosha, se është e
15 vështirë që të analizohet konteksti nga i cili është marrë një
16 apo dy faqe të një libri. Tani unë nuk po ju kërkoj juve që të
17 na jepni të gjithë librin, por në kuadër të procesit tuaj, do
18 ju lutesha të shqyrtonit nëse është e mundshme që t'i
19 bashkonit këtyre faqeve dhe faqe apo pjesë të tjera të këtyre
20 librave për të vlerësuar më saktë kontekstin e librit apo të
21 faqeve nga është marrë libri sepse është e vështirë që të
22 analizohet kjo faqe pa e ditur ç'është thënë përpara apo
23 ç'thuhet pastaj më prapa faqes përkatëse.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit për udhëzimin tuaj.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe sa i

1 takon çështjes së mocioneve për provat jогоjore - ju keni
2 punuar këtu, por mund të punoni dhe më shumë - ja vlen shumë
3 që të bëni diskutimet ndër palëve. Një përqindje shumë e madhe
4 për këto materiale mund të mos ketë kundërshtime ose mund të
5 merrni dhe indicie prej tyre nëse kanë apo jo kundërshtim për
6 materiale të caktuara. Besoj se kjo mund të zgjidhet përmes
7 diskutimeve mes palëve drejtpërdrejt.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kuptova. Do ta bëjmë këtë edhe
9 në kuadër të procedurës së mocionit për provat jo gojore duke
10 ndjekur dhe procedurën jashtë sallës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po për Trupin
12 Gjykses keni ndonjë pyetje për këtë çështje?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nga ZPS-ja nuk kemi.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani i
15 kthehem Ekipeve të Mbrojtjes.

16 Unë e thashë çfarë kisha për të thënë gjënë e parë, do të
17 kemi pra, parashtrimin e njëkohshëm të dosjeve gjyqësore.

18 Po kështu duam që të shikojmë nëse ka ndonjë problem që
19 përbën shqetësim për avokatin e mbrojtjes sa i takon
20 dëshmitarëve të mbetur që do të thërrasë Prokuroria.

21 Do t'i marrim me radhë të gjithë avokatët, keni diçka për
22 të thënë lidhur me këtë?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne nuk kemi shqetësim për
24 dëshmitarët, nuk kishim, pra, ndonjë shqetësim lidhur me këtë
25 çështje para se të dëgjonim përditësimin që tha Prokuroria.

1 Unë do flas në emër të ekipit tim. Shqetësimi im është se
2 pikësëpari do të ketë një farë aktiviteti midis datës 4 prill
3 dhe 15 prillit, që është përmendur në parashtrimet e
4 Prokurorisë. Unë nuk jam i sigurtë se çfarë synojnë ato të
5 parashtrojnë në atë periudhë, por ne na duket se kjo është një
6 periudhë e vonët. Them e "vonët", sepse lidhet me disa pika të
7 tjera, sidomos pika 6 për të cilën do të na pyesni më pas. Por
8 duke pasur parasysh vëllimin e materialeve për të cilin po
9 flasim tani, ne mund -- por nuk mund të fillojmë që të
10 parashtrojmë mocionet tona nëse ka shumë materiale të cilat
11 dorëzohen, kërkesa që bëhen në atë kohë dhe mbase dhe kërkesa
12 të tjera sipas rregullës 153, 155, deri më datë 4 prill apo
13 edhe mbase kësaj date.

14 Unë e parashikoj, qoftë edhe për arsye personeli, sidomos
15 për ekipin tim - sepse disa prej nesh po merren me dy çështje
16 gjyqësore tani - vëllimi i materialit për të cilin do të na
17 duhet të merremi brenda 30 apo 35 ditëve deri në mbylljen e
18 parashikuar të paraqitjes së provave nga Prokuroria është një
19 barrë shumë e madhe për ne dhe besoj se duhet ta dini që tani.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të besoni që
21 ne jemi vetëm tetë vetë edhe neve na duhet që të merremi me të
22 gjitha këto materiale. Kështu që ju kuptoj. Ju kuptoj. Po
23 megjithatë është një punë që na duhet ta bëjmë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Por nëse e kemi një mocion për
25 prova jo gojore që e kemi marrë dje, për shembull, 500 e ca

1 materiale që marrin, për shembull, etiketimin "Shtabi i
2 Përgjithshëm apo zona operative përkatëse", janë dokumente të
3 cilat duhen analizuar nëse kanë rëndësi, kanë lidhje me
4 çështjen gjyqësore apo jo.

5 Do të na duhet t'i përgjigjemi Prokurorisë brenda javës
6 së ardhshme, nuk ka gjasa do thosha që ne do të kemi mundësi
7 që ne t'i shikojmë me radhë të gjithë këto materiale brenda
8 këtyre dy javëve.

9 E them këtë sepse besoj se ju jeni në dijeni duke pasur
10 parasysh që këtë sasi materiali do ngadalësohen gjërat, plus
11 janë mocionet për provat jo gojore, plus janë edhe kërkesat
12 sipas rregullave 153 dhe 155. Është në interesin tonë dhe
13 interesin e klientëve tanë që të ecim sa më shpejtë,
14 sigurisht, por ky është problem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Pika tjetër.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse mund të shtoj diçka lidhur me
18 këtë? Parashtrim se Prokuroria nuk ka për ta mbyllur
19 paraqitjen e provave më datë 15 prill nëse ato do vazhdojnë që
20 të dorëzojnë mocione që ne na duhet që ne t'i përgjigjemi e
21 tjerë dhe ju të merrni vendime. Përfundimi i paraqitjes së
22 provave nga ata është mbasi të jenë marrë vendimet tuaja.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rregulla
24 thotë që kur janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët dhe janë
25 paraqitur të gjitha materialet, atëherë quhet që është mbyllur

1 paraqitja e provave. Nuk kërkon kjo që ne t'u përgjigjemi çdo
2 mocioni.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Por mund të shikohet nga mënyra
4 tjetër, që ne mund të themi që afati për të shqyrtuar dhe
5 dorëzuar mocionet përkatëse mund të fillojë nga momenti kur ne
6 e dimë se cilat janë provat.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po s'e thotë
8 rregulla. Në mënyrë konkrete thotë që kur mbyllë paraqitjen e
9 provave Prokuroria, ju menjëherë duhet të na informoni nëse
10 synoni, apo jo, që të dorëzoni një rregull, pra, një mocion të
11 rregullës 130.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Po ne na duhet të dimë se cilat janë
13 provat që paraqet Prokuroria.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk po
15 them se çfarë besoni ju. Po këtu po flasim se çfarë thotë
16 rregullorja. Dhe me rregulloren kemi të bëjmë, atë duhet të
17 zbatohet.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Thjesht, ne duam t'ju parashtrojmë
19 këtë që duhet të na lejoni afat të mjaftueshëm që të jemi në
20 gjendje t'u përgjigjemi të gjitha mocioneve, sepse disa prej
21 tyre mund të dorëzohen jo më herët se data 15 prill dhe ju
22 duhet të merrni vendim dhe për to.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë mendoj se
24 rregulla parashikon që ju do të vazhdoni që të informoheni
25 vazhdimisht se çfarë dorëzohet dhe duhet të jeni në gjendje që

1 të thoni po apo jo, nëse do të paraqisni një mocion të
2 rregullës 130.

3 Ne do bëjmë çmos që të nxjerrim përgjigje dhe, sigurisht,
4 presim nga ju që të jepni disa argumente në një dokument
5 parashtrues. Por mocioni i rregullës 130 është i parashikuar
6 shumë qartë nga rregullorja dhe duam t'i ndjekim këto
7 rregulla.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Po edhe ne duam të ecim sa më
9 shpjët.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka të
11 bëjë me shpejtësinë këtu. Ka të bëjë me respektimin e
12 rregullave.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Po deshëm të themi që kemi nevojë
14 për afat të mjaftueshëm që të shqyrtojmë të gjitha materialet
15 përpara se të vendosim nëse do të dorëzojmë një mocion të
16 rregullës 130 apo jo. Kjo është ajo që donim të thoshim.

17 Edhe dy çështje të tjera i kam për t'i diskutuar. E para,
18 ka të bëjë me numrin e dëshmitarëve që do të dëgjohen në
19 sallë, që mbeten për t'u dëgjuar.

20 Ne kemi përllogaritur se janë së paku dhjetë dëshmitarë
21 të cilët mbeten për t'u dëgjuar -- është në bllokun e marsin.
22 Po janë shumë për t'u përgatitur për dhjetë të tillë dhe nëse
23 nuk do të thirren duhet që ta dimë, pra, deri në fund të javës
24 së ardhshme Prokuroria të na informojë se nëse krahas një
25 dëshmitar që e dinë që do vijë a do kenë dhe dëshmitarë të

1 tjerë apo jo.

2 Sigurisht, ato mund të dorëzojnë kërkesat e tyre
3 përkatëse, po të paktën ta dimë që deri në fund të këtij
4 blloku nëse do na duhet të përgatitemi për një, dy, tre apo
5 për dhjetë dëshmitarë. Sepse është një diferencë shumë e madhe
6 sa i takon burimeve tona në personel për t'u përgatitur për
7 dëshmitarët. Duam një afat, që të vendosni një afat për të
8 ditur sesa dëshmitarë do dëgjohen.

9 Dhe, e fundit, është që ne kërkojmë që të jepen arsye sa
10 i takon vendimit për dosjet e njëkohshme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të fusim
12 në dokumentacionin gjyqësor urdhrin tonë. Patjetër, me
13 argumentim.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju
16 përgjigjeni kërkesës për dhjetë dëshmitarët? Ju lutem, sa më
17 konkretisht, se po i afrohem fundit dhe ky informacion na
18 nevojitet.

19 Z. PACE: [Përkthim] Po. Numri që përmend avokati janë
20 dhjetë dëshmitarë që mbeten, dhjetë dëshmitarë për të cilët
21 mbeten për t'u dëgjuar si numër është i saktë.

22 Po nga këto të dhjetë, siç e thamë, me gjasë shumë ose të
23 paktën disa prej tyre do të ndryshojnë në dëshmitarë të
24 rregullës 153, 154 ose do t'i heqim fare nga lista e
25 dëshmitarëve. Nuk mendojmë se të dhjetë dëshmitarët do të

1 dëgjohen në bllokun e marsit. Dhe as nuk do të dëgjohen përtej
2 kësaj data. Sa i takon vendosjes së një afati, kjo është
3 arbitrare. Sepse problemet me të cilat përballemi nuk kuptohen
4 mirë, janë probleme që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e
5 dëshmitarëve, sigurinë e dëshmitarëve dhe sidomos
6 bashkëpunimin me shtetet e treta.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një sekondë.
8 Ju e dini se me cilët dëshmitarë keni problem. Nëse ju nuk e
9 dini, atëherë unë nuk e di se çfarë bëni. Sepse ju duhet ta
10 dini nëse këta persona kanë probleme të mundshme që mund t'i
11 pengojnë ardhjen e tyre këtu, ju duhet ta dini. Po edhe
12 avokatët e Mbrojtjes duhet ta dinë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Po, ne e dimë. Ne e dimë se kush kanë
14 probleme.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju e dini se
16 kërkoj do thërrisni këtu në bankën e dëshmitarëve dhe kush do
17 të jetë në bankën e dëshmitarëve dhe dëshmitarët për të cilët
18 ju s'jeni të sigurtë. Dhe këtë informacion dua t'ia komunikoni
19 sa më shpejtë avokatëve.

20 Z. PACE: [Përkthim] Unë shikoj vlerë për të informuar
21 Mbrojtjen se cili mund të vijë, cili mund të mos vijë, pa e
22 marrë ne një vendim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'më kuptuat.
24 Ju e dini se ka disa që i doni se zbën të vijnë këtu, të jenë
25 të pranishëm në sallë?

1 Z. PACE: [Përkthim] Nga të dhjetë dëshmitarët, të dhjetë
2 duam që të jenë këtu. Fakti që s'do jenë këtu, që mund të mos
3 jenë këtu, është se mund të kenë probleme të caktuara që i
4 pengojnë. Nëse nuk do të jemi në gjendje t'i sjellim këtu do
5 t'i dorëzojmë me provat shkresore.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse nuk
7 dallim -- nëse ne do caktojmë një afat do japim dhe arsyetimin
8 përkatës.

9 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk po themi se ne do informojmë
10 Mbrojtjen vetëm një javë përpara. Nëse për ndonjë prej
11 dëshmitarëve ne i parashikojmë, i planifikojmë që të vijnë
12 këtu dhe duhet t'i japim njoftim dhe Mbrojtja pastaj thotë që
13 nuk është gati, do ta mbajmë parasysh këtë. Por sa i takon
14 caktimit të një afati, kjo s'është në fyzën tonë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më falni që ju ndërpres, po
16 nuk është vetëm për Mbrojtjen po është edhe për Trupin
17 Gjykses. Trupi Gjykses gjithashtu përgatitet për dëshmitarët
18 në mënyrë që të jemi në gjendje të bëjmë pyetjet e duhura.
19 Kështu që edhe ne kemi nevojë të dimë se kë do thërrisni, kë
20 do hiqni nga lista.

21 Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa më shpejt
23 ta bëni këtë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Po. Siç e thashë, këtë javë do të
25 informojmë për katër a pesë ndryshime, pra, për disa prej

1 dëshmitarëve. Dhe gjithashtu do të japim një përditësim të më
2 tejshëm javën e ardhshme. Dhe menjëherë sa të kemi mundësi do
3 të japim përditësimet e tjera.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është arbitrare vendosja e
5 afatit. Sepse rregullorja e kërkon që ata deri të enjten e
6 ardhshme të na informojnë se kush do të jenë në bllokun e
7 marsit.

8 Pra, afati ekziston.

9 E dyta është se këto probleme që kanë me dëshmitarët me
10 siguri nuk kanë lindur tani, kanë muaj që ekzistojnë. Të
11 paktën javë për të mos thënë muaj. Pra, nuk është diçka që u
12 ka dalë papritur sot edhe i duhet kohë Prokurorisë të kuptojë
13 sesi do ta zgjidhë problemin.

14 Së paku ju duhet që të kërkonit respektimin e afateve që
15 parashikon rregullorja në mënyrë që ato të na informojnë
16 brenda afatit përkatës nëse do t'i sjellin këta dëshmitarë
17 këtu në sallë apo jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu do
19 veprojmë. Synojmë që ta bëjmë këtë gjë se nuk e kemi miratuar
20 në rregulloren. Rregullorja është aty, por ju lutem
21 përgatituni për të respektuar këto rregulla.

22 Besoj se s'jeni në gjendje sot të thoni nëse do të
23 dorëzoni mocionet sipas rregullës 130, pra, ka më shumë gjasë
24 të dorëzoni apo ka më shumë gjasa të mos dorëzoni mocione të
25 tilla?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Së pari do them dy gjëra. Ju na
2 kërkuat që t'i drejtoheni, për shembull, kësaj çështjeje në
3 konferencën e fundit, sigurisht për të pasur një vendim nga
4 ana jonë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po e kemi
6 diskutuar këtë dhe e mbajmë parasysh.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është gjëja e parë që kemi për
8 të thënë si Mbrojtja e z. Thaçi.

9 Së dyti, mendoj se mund të thuhet, që duke pasur parasysh
10 këtë kusht dhe në mungesë të informacioneve nga Trupi Gjykses,
11 ne do të përgatitemi sikur do të ketë mocion të rregullës 130,
12 thjesht për ta mbajtur ju parasysh për planifikim. Por kjo
13 mund të ndryshojë në bazë të disa prej faktorëve një prej të
14 cilëve është edhe pyetja që unë i bëra Trupit Gjykses në
15 konferencën e fundit për ecurinë e çështje.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Në emër të Mbrojtjes së z. Veseli.
17 Edhe ne do të ecim në bazë të presupozimit që do ketë një
18 mocion të tillë, po kjo kushtëzohet nga disa faktorë.

19 Po ka më shumë gjasë të dorëzojnë mocion të tillë, sesa
20 të mos dorëzojnë mocion të tillë, kjo duhet mbajtur parasysh
21 për planifikim. Edhe po të ketë ndonjë ndryshim do t'ju
22 informojmë menjëherë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Problemi i
24 kalendarit ka të bëjë se t'i e bën një kalendar, po nëse ka
25 një ndryshim pastaj ky kalendar nuk ka më vlerë. Ne mund të

1 bëjmë një kalendar po edhe mund të mos ta bëjmë pa e ditur
2 përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve. Unë i kuptoj kufizimet. Nuk
3 po i kundërshtoj këto, sigurisht. S'po debatoj. Po parashikimi
4 i afateve për dosjet paragjyqësore do të bëhet nga ana jonë
5 pasi të jetë marrë ky vendim. Pastaj nuk ka kuptim që të bëhet
6 ky, pra, derisa të merret ky vendim, nuk ka kuptim që të bëhet
7 një kalendar se s'e dimë sesa kohë do ju duhet për mocionet.
8 Sa kohë ju duhet t'i dorëzoni. Sa kohë do na duhet ne që t'i
9 shqyrtojmë. Pra, nuk mund t'jua jap që tani këtë përgjigje.

10 Dhe kjo në mënyrë konkrete është se ju na pyetët herën e
11 fundit nëse ne mund t'i parashikojmë në kalendar, pra, të
12 vendosim afate për këto. Përgjigja është se, jo, nuk mund ta
13 bëjmë dot këtë gjë pa pasur një përgjigje për mocionin sipas
14 rregullës 130. Mbase ju e dini çfarë do bëni, mbase ju nuk e
15 dini. Por duhet të na e jepni këtë përgjigje, kjo është
16 pengesa që kemi përpara.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Kërkesa jonë kjo ishte që të na
18 jepnit një afat, një periudhë që ne ta dimë që sa kohë do ju
19 duhet ju për shqyrtimin, sa kohë do ju duhet Prokurorisë për
20 përgjigjen, duhet të dinim cilat janë afatet në kalendar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, besoj se
22 ju e thatë që juve ju nevojiten tre javë.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Katër javë thamë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Katër javë
25 dhe jam i sigurtë që edhe Prokuroria ka të paktën një ditë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] I kërkuam një zgjatje reciproke
2 për një muaj që është e pranueshme. Besojmë që do të zgjidhte
3 shumë probleme që z. Misetić ngriti më herët.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ju
5 them që kërkesa është e arsyeshme. Katër javëshe, pra. Katër
6 javë apo jo? Katër javë dhe një javë, pra. Dhe një javë. Por
7 gjithashtu keni thënë që më duket kërkonit dhjetë javë për
8 dosjen përfundimtare. Ne s'kemi problem me këtë kërkesë.
9 Thjesht duhet për ta futur në kalendar nuk ka kuptim, se
10 s'dihet si vazhdojë më tej.

11 Do t'ju jepet gjithsesi kohë e mjaftueshme për dosjen
12 përfundimtare.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Ju falënderojmë për këtë
14 informacion. Na jep kjo mundësi neve që të paktën të bëjmë
15 përgatitjet tona. Asgjë detyruese normalisht. Por mbi këtë
16 bazë e këto udhëzime kohore na duken të pranueshme.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Pastaj kemi pushimet e verës që do të ndikojnë në kalendar dhe
19 të gjitha këto dhe do të merremi me kërkesën, por kërkesa
20 është e arsyeshme. Natyrisht që pas dy viteve gjykim, nuk duam
21 që t'ju kufizojmë në dosjen tuaj përfundimtare. Dhe do ketë
22 gjithashtu dhe periudhë kohore të mjaftueshme meqenëse janë të
23 njëkohshme për të pranuar edhe dosjet e tjera që dhe komentet,
24 përgjigjet, kundërpërgjigjet që janë të nevojshme.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Natyrisht, gjithashtu dhe çështja

1 për provat e Mbrojtjes, përgatitja, paraqitja e tyre.

2 Udhëzimet që janë dorëzuar në afatet kohore të propozuara,
3 duken të pranueshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në
5 përgjithësi janë pranuar. Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të ngre një çështje, ju
7 lutem?

8 Ka të bëjë me një pikë që përmendët ju lidhur me
9 rregullën 129, 130. E kuptoj që rregulla është e shkruar, por
10 qëndrimi jonë është se Prokuroria nuk do ta përbyllë
11 paraqitjen e provave të tyre derisa të merren vendimet mbi
12 pranueshmërinë apo jo të provave të dorëzuara. Pra, në qoftë
13 se ka akoma kërkesa për pranim provash, çështja nuk është
14 mbyllur.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çështja e
16 tyre mund të përbyllet. Dhe ne duhet pastaj të marrim vendime
17 lidhur me mocionet. Fatkeqësisht për atë, nëse ne nuk pranojmë
18 diçka, nuk ka çka të bëhet në atë pikë.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Por ne nuk e di se a mund të
20 dorëzojmë një gjë të tillë, a ka prova të pamjaftueshme pa
21 ditur cilat janë provat, pra, mund të paraqesim që ka provat
22 janë të pamjaftueshme, pa ditur paraprakisht se a ka prova.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
24 janë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Ka, janë më shumë se një mijë

1 prova materiale.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
3 përshpejtojnë këtë gjë dhe ecin më shpejtë do të ishte mirë.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Pajtohem me ju. Por që të kthehem
5 tek pika që thatë më herët, çështja që e ngrita ka të bëjë me
6 dokumentet që mund të lidhen me çështjen dhe ne flasim për
7 rregullën, pra, parashtimet sipas rregullës 130?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa më përket mua, z.
9 Misetiç - mendoj që ju e thatë edhe herët e fundit - janë
10 rregullat janë ato si janë, çështja e Prokurorisë do të
11 mbyllet. Por qëndrimi juaj është që për të cilin edhe unë
12 pajtohem, është që rregulla 130 nuk mund të dorëzohen, pra,
13 prova sipas saj përveç nëse vendimet janë marrë mbi
14 pranueshmërinë apo jo të provave. Me fjalë të tjera, ju nuk do
15 të ishit në gjendje të argumentoni provat tuaja bazuar në atë
16 që ju dini që është në dosjen e lëndës.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Atëherë e kemi të
18 qartë.

19 Z. HALLING: [Përkthim] T'i përgjigjem shkurtimisht.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Sepse mendoj që parashtimi në
22 vetvete është hipotetik.

23 Dhe, të nderuar Gjykatës, në Çështjen 07, rregulla,
24 vendimi sipas rregullës 130, të paktën janë -- parimi është i
25 njëjtë që është ndjekur dhe është bërë një, sipas një -- në

1 mënyrë sipas rendit, pra, provat janë cituar për qëllime
2 ilustrative. Më duket shumë e pagjasë mënyrën sesi është bërë
3 numërimi i tyre që materialet e papranuara të kenë dallim të
4 tillë në zgjidhjen e problemit, vendimit sipas rregullës 130.
5 Mbrojtja nuk kërkon që ky informacion -- këtë informacion në
6 mocionin e tyre.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, ju a doni që
8 Mbrojtja të bëjë parashtrime pa e ditur cilat janë provat që
9 janë pranuar?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Po, është kështu. Ne sigurisht që
11 nuk duam që t'i kërkojmë Trupit Gjykues që të zgjidhim
12 problemin e mocioneve që janë, mbi të cilat nuk është marrë
13 akoma vendim një muaj përpara përmbylljes së paraqitjes së
14 provave. Kjo i përket Gjykatës që të vendojë atë.

15 Ajo që po them është që nuk është kërkesë, nuk është
16 kusht për dorëzimin e dosjes për hedhjen, rrëzimin e akuzave.
17 Është shumë e qartë që, në qoftë se diçka dorëzohet por nuk
18 pranohet, paraqitet si provë por nuk pranohet, statusi i kësaj
19 gjëje është i qartë. Mund të përdoret nga Trupi Gjykues, mund
20 të mos përdoret dhe parashtrimi mund të bëhet në përputhje me
21 këtë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne natyrisht jemi tërësisht kundër
23 kësaj, dhe mendoj që parashtrimi që është bërë më herët lidhur
24 me rregullën 130 do të thotë që sa i takon pikave, pjesëve apo
25 disa pjesëve për të cilat do të debatohen, ne kemi të drejtën

1 që të t'i kundërshtojmë ato. Faleminderit.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Misetiç, desha t'i kthehem
3 çështjes që ju mbi të cilën -- z. Misetiç, do të kthehem tek
4 pyetja që ju bë Trupit Gjykyes në konferencën e fundit dhe do
5 ta lexojë atë. Ju thatë:

6 "... çështja është: Nëse do të ketë Mbrojtja prova për të
7 paraqitur apo jo dhe Mbrojtja kundërshton mjaftueshmërinë e
8 provave që ndaj të cilave duhet të përgjigjen, në këtë rast
9 Trupi Gjykyes a do të kalojë tek përgatitja e dosjes
10 përfundimtare dhe argumenteve përfundimtare?"

11 Kjo ishte pyetja.

12 Pra, mesa kuptoj unë rregulla 130 në këtë fazë dhe gjithë
13 Ekipet e Mbrojtjes në qoftë se ata zgjedhin që të mos
14 paraqesin prova të Mbrojtjes, atëherë logjikisht i bie që
15 kalojmë në fazën e paraqitjes së dosjes përfundimtare dhe
16 argumenteve përfundimtarë. Ça mund të bëhet tjetër për të
17 konfirmuar këtë dhe në qoftë se kështu është, kështu është
18 atëherë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por duhet të
20 marrin pjesë në këtë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] ZPS-ja -- Mbrojtja ka çështjen e
22 saj, provat e saj. Pastaj në qoftë se ka, do ketë prova, prova
23 që do të marrë vetë Trupi Gjykyes sipas rregullës 132. Pyetja
24 jonë në thelb është që Trupi Gjykyes, qëndrimi sa i përket
25 Trupit Gjykyes është që nëse, le të themi, ata nuk arrijnë të

1 vërtetojnë akuzat që kanë ngritur, nuk kanë prova të
2 mjaftueshme dhe ne dëshirojmë ta kundërshtojmë këtë. Ne në
3 fazën -- atëherë në këtë fazë roli i Trupit Gjykses është që
4 të lëvizë, të ecë në këtë drejtim. Pra, ne e kundërshtojmë
5 natyrisht mjaftueshmërinë e provave dhe kalojmë atëherë në
6 paraqitjen e argumenteve përfundimtarë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Çfarë dëshironi të dini
8 atëherë nëse Trupi Gjykses do të thërrasë dëshmitarë?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Sepse kjo ka pasoja në
10 paraqitjen e provave tona që të parashtrime apo jo lidhur me
11 këtë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptoj.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
14 Smith.

15 Misetic, kam edhe një pyetje për ju, çështje organizimi
16 të brendshme. E përgjithshme besoj. E kuptoni.

17 Por më 14 shtator 2022, ju bëtë një -- ju përdorët një
18 dokument. Ishte raporti i marsit 1999 nga një organizatë me
19 numrin ERN të caktuar. Dhe tani, juve ju kërkua të na bëni të
20 qartë nëse dëshironi t'i paraqisni këto dokumente si provë dhe
21 ju thatë që kishit nevojë për më shumë autorizime nga burimi,
22 pra, personi që ju kishte apo autoriteti që ju kishte dhënë
23 këto dokumente.

24 Desha të di nëse keni bë ndonjë lëvizje lidhur me këtë?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk bej -- besoj që më kujtohet

1 dokumenti dhe ju keni të drejtë. Besoj që e kemi marrë
2 autorizimin për të paraqitur këtë si provë dhe do ta bëjmë
3 këtë sapo të vijë mundësia.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam asgjë për të
6 shtuar. Thjesht desha të nënvijëzoj faktin që pjesa që mungon
7 në kronologjinë siç po ecën përpara, mendoj që e kemi pranuar
8 këtë. Nuk kam gjë për të thënë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi të
10 vetëdijshëm që dhe ju keni nevojë për disa udhëzime nga ajo që
11 pritet për ekspertin tuaj pra, që do të paraqisni. Është
12 kështu?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Jemi në procesin e udhëzimeve, që do
14 u japim udhëzime ekspertëve dhe njëri prej tyre, ai që do të
15 kërkojë më shumë kohë për të dhënë dëshmi, është udhëzuar që
16 në këtë proces të përgatisë një raport, një raport që do të
17 jetë i gatshëm në prill.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 A ka ndonjë çështje tjetër që do të ngrini?

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje për
21 Mbrojtjen që të jem i qartë lidhur me rregullën 130. A është
22 qëndrimi i Mbrojtjes që ju nuk jeni në gjendje të vendosni
23 nëse do të paraqisni mocione të tilla apo jo deri në momentin
24 kur ne të kemi vendosur mbi kërkesat që janë parashtruar? Nuk
25 po ju kërkoj që të bëni parashtrimet e tuaja, z. Misetiç, para

1 asaj pike, por thjesht po ju pyes nëse do të jeni në gjendje
2 të bëni parashtrime të tilla, kur mendoni që mund ta bëni?
3 Vetëm kur të jenë trajtuar të gjitha provat jo gojore dhe ato
4 të parashtruara sipas 154, 155, pra, kur të jenë marrë
5 vendimet lidhur me këto?

6 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që edhe këtu me kusht që të
8 presim qëndrimin e Trupit Gjykues lidhur me pyetjen që bëra,
9 po ne do të jemi në gjendje të japim qëllimin, synimet tona
10 lidhur me mocionin, paraqitjen e një mocioni. Por, përsëris
11 edhe një herë që nuk do jemi në gjendje që të përgatitemi dhe
12 të paraqesim atë përpara vendimit përfundimtar nga Trupi
13 Gjykues pra.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, duhet të jeni në
15 gjendje të na thoni neve që jeni në gjendje që të parashtroni
16 një të tillë nga fundi kur të përfundojë çështja e
17 Prokurorisë, paraqitja e provave të Prokurorisë?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Mesa kuptoj unë data është 15 prill,
21 do të jemi në gjendje t'ju japim disa informacione. Siç e
22 thashë më herët, janë 30 ditë që fillojnë, afati 30 ditësh nga
23 faza e fundit e paraqitjes së provave, përfshirë nëse do të
24 ketë dëshmitarë të rëndësishëm që do të futen sipas rregullës
25 153, 155. Të gjitha këto duhet të merren parasysh, janë të

1 rëndësishme për t'u marrë parasysh për secilën prej pikave të
2 akuzave që ne mund të dëshirojmë të kundërshtojmë si në një
3 mocion të paraqitur sipas rregullës 130.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
5 Që nga fillimi e kam vlerësuar datën 15 prill si fundi i
6 çështjes së Prokurorisë. Kjo data 4 prill doli muajin e kaluar
7 apo diçka e tillë. Po gjithmonë e kam menduar se është data 15
8 prill kur do të përfundojmë që para dy vitesh.

9 Diçka tjetër?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Një çështje të fundit përpara që
11 të -- sa i përket provave të Mbrojtjes që ne dëshirojmë të
12 përmendim këtu.

13 Janë bërë diskutime lidhur me çështjen se kur Mbrojtja
14 mund të fillojë të paraqesë provat e saj në rast se do të
15 paraqesin prova, pra, por kemi dhe një afat kohor paraprak që
16 lidhet me rregullën, me afatet sipas rregullës 119(2).

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe kjo është diskutuar në këto
19 seanca. Në Çështjen 07 kjo gjë është bërë brenda pak ditësh
20 pas vendimit sipas rregullës 130. Dhe është afat i
21 rëndësishmen për ne. Kjo që të na japë mundësinë që të bëjmë
22 hetime dhe të kërkojmë bashkëpunimin e nevojshëm për
23 paraprovat e Mbrojtjes.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që kjo
25 do të trajtohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas

1 përfundimit të provave tuaja.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë kemi
4 bërë edhe në gjykimin paraprak ku kemi qenë të përfshirë dhe
5 nuk ka arsye që të bëjmë ndryshe.

6 Diçka tjetër?

7 Z. DIXON: [Përkthim] Kishim thjesht një kërkesë lidhur me
8 parashtrimin F2944 dhe kjo do të kërkonim 7 ditë të zgjatje të
9 afatit për ta bërë këtë. Bëhet fjalë për më shumë se 200
10 dokumente. Prokurori nuk e kundërshtim zgjatjen e kësaj, pra,
11 që të paraqesim këtë më datë 7 mars.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshironi t'i
13 përgjigjeni kësaj?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo varet nga përgjigja, çfarë
15 thuhet në përgjigje, të nderuar Gjykatës.

16 Mendoj që ka gjasa që të ketë diçka të cilës do t'i
17 përgjigjemi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
19 zgjatja, kjo kërkesë për zgjatje miratohet.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë thashë që
22 nuk e di që a do ta -- nuk e di a kemi zgjidhur ndonjë gjë,
23 por biseduam për të. Të gjithë e dinë se ku janë shqetësimet
24 dhe kjo ndihmon që të ecim përpara.

25 Pra, do të shihemi të hënën, po, të hënën është në fakt.

1 Dhe ju falënderoj për praninë tuaj sot këtu. Kërkoj ndjesë për
2 organizimin e kësaj konference në afat të shkurtër, por
3 kishim, shpresonim që mund të kishte më shumë se një dëshmitar
4 këtë javë derisa u bë e qartë që nuk do të kishte. Kështu që
5 faleminderit. Shihemi të hënë.

6 --- Seanca mbyllet në orën 09.55

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25